<p>e ndalon çfarëdo keqpërdorimi të këtyre të dhënave.</p> <p>4. Masat e përkohshme nga paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni mund të shqiptohen pa e informuar palën kundërshtuese, nëse aplikuesi vërteton se masat tjera nuk do të ishin efektive, apo se çfarëdo vonese do të shkaktonte dëm të pariparueshëm për të. Në rast të tillë, palët duhet të informohen pa vonesë, dhe më së largu pas ekzekutimit të masave. Një shqyrtim, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar, bëhet sipas kërkesës së palës kundërshtare me qëllim të vendosjes, brenda kohës së arsyeshme pas njoftimit për masat, nëse këto masa duhet ndryshuar, revokuar apo konfirmuar.</p> <p>5. Në vendimin ku urdhërohet masa e përkohshme, gjykata e specifikon kohëzgjatjen e masës dhe nëse masa është urdhëruar para fillimit të procedurës për çështjet meritore të rastit, periudha brenda së cilës duhet të iniciojë padinë për të arsyetuar masën, e që nuk duhet t'i kalojë njëzet (20) ditë pune apo tridhjetë e një (31) ditë kalendarike nga data e njoftimit të masës së përkohshme, cilado që është më e gjata. Në mungesë të një kërkesë për të filluar procedurë për çështjet meritore të rastit brenda periudhës së lartcekur, i padituri mund ta kërkojë revokimin ose pushimin e efektit të masave të përkohshme.</p>	<p>information and prohibit any misuse of this data.</p> <p>4. The interim measures referred to in paragraphs 1, 2 and 3 of this Article may be imposed without informing the opposing party, if the applicant proves that other measures would not be effective, or that any delay would cause irreparable damage to him/her. In such case, the parties shall be informed without delay, and at the latest after the execution of measures. An examination, including the right to be heard, shall be conducted at the request of the opposing party for the purpose of deciding, within a reasonable time upon the notification of measures, whether such measures should be amended, revoked or confirmed.</p> <p>5. In the decision ordering the interim measure, the court shall specify the duration of the measure and if the measure was ordered before the commencement of the proceedings on the merits of the case, the period within which it should be initiated the claim to justify the measure, which should not exceed twenty (20) working days or thirty one (31) calendar days from the date of notification of the interim measure, whichever is longer. In the absence of a request to initiate proceedings on merit-based cases within the above period, the respondent may request to revoke or cease the effect of the interim measures.</p>	<p>4. Privremene mere iz stava 1, 2. i 3. ovog člana mogu se izreći bez obaveštavanja protivne strane, ako aplikant dokaže da druge mere ne bi bile efikasne ili ako bi mu svako odlaganje nanelo nepopravljivu štetu. U tom slučaju, strane moraju biti obavestene bez odlaganja, a najkasnije nakon izvršenja mera. Ispitivanje, uključujući pravo na saslušanje, obaviće se na zahtev protivničke strane radi odlučivanja, u razumnom roku nakon obaveštavanja o merama, da li takve mere treba izmeniti, opozvati ili potvrditi.</p> <p>5. U odluci kojom se naređuje privremena mera, sud će odrediti trajanje mere i ako je mera naložena pre početka meritornog postupka, rok u kojem mora pokrenuti parnicu radi opravdanja mere, koji ne sme biti duži od dvadeset (20) radnih dana ili trideset jednog(31) kalendarskog dana od datuma obaveštenja o privremenoj meri, zavisno od toga šta je duže. U odsustvu zahteva za pokretanje meritornog postupka u gore navedenom roku, tuženi može zahtevati opoziv ili prestanak dejstva privremenih mera.</p>
--	--	--

<p>6. Gjykata në lidhje me masat e referuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, do të kërkojë nga mbajtësi i dizajnit çfarëdo dëshmie që justifikon një shkallë të mjaftueshme të sigurisë se është mbajtës i të drejtave dhe se të drejtat janë shkelur apo se një shkelje e tillë është e pashmangshme.</p> <p>7. Nëse masa e përkohshme revokohet apo skadon për shkak të një vepre ose lëshimi nga paditësi, apo nëse vërtetohet se nuk ka pasur shkelje ose kërcënim të shkeljes së një dizajni, me kërkesë të kundërshtarit, gjykata mund ta urdhërojë paditësin që të ofrojë kompensim adekuat për çfarëdo dëmi të shkaktuar nga këto masa.</p>	<p>6. The court shall, in relation to the measures referred to in paragraphs 1, 2 and 3 of this Article, require from the design holder any evidence that justifies a sufficient degree of certainty that he/she is the holder of the rights, and that the rights have been infringed or that such an infringement is inevitable.</p> <p>7. The interim measure shall be revoked or expired due to an act or omission by the claimant, or if it is verified that there was no infringement or threat of infringement of a design, at the request of the opponent, the court may order the claimant to provide adequate compensation for any damage caused by these measures.</p>	<p>6. Sud će, u odnosu na mere iz stavova 1, 2. i 3. ovog člana, zahtevati od nosioca dizajna bilo koje dokaze koji opravdavaju dovoljan stepen sigurnosti da je on nosilac prava i da su prava povređena ili da je takva povreda neizbežna.</p> <p>7. Privremena mera se ukida ili ističe usled dela ili propusta tužioca, ili ako se utvrdi da nije bilo kršenja ili pretnje kršenjem dizajna, na zahtev protivnika sud može naložiti tužiocu da obezbedi adekvatnu nadoknadu za štetu nastalu ovim merama.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 67 Masat e përkohshme për ruajtjen e dëshmisë</p> <p>1. Me kërkesë të pronarit të dizajnit i cili ka ofruar dëshmi për të vërtetuar se dizajni është shkelur ose mund të shkelet, dhe është e mundur që dëshmia relevante nuk mund të sigurohet ose do të bëhet me e vështirë të sigurohet, gjykata mundet që, edhe para fillimit të procedurës për çështjet meritore, të urdhërojë masë të përkohshme për ta ruajtur dëshminë me kusht të mbrojtjes së informacionit konfidencial.</p> <p>2. Përmes masës së përkohshme të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, gjykata mund ta urdhërojë në veçanti:</p>	<p style="text-align: center;">Article 67 Interim measures for preserving evidence</p> <p>1. At the request of the design owner, who provided evidence verifying that his/her design has been infringed or can be infringed, and it is possible that the relevant evidence cannot be provided or it would be difficult to provide it, the court may, before the commencement of the procedure on merit-based cases, order an interim measure to preserve the evidence provided that the confidential information is preserved.</p> <p>2. Through interim measures referred to in paragraph 1 of this Article, the court may order in particular:</p>	<p style="text-align: center;">Član 67 Privremene mere za očuvanje dokaza</p> <p>1. Na zahtev vlasnika dizajna koji je pružio dokaze da dokazuje da je dizajn prekršen ili da može biti prekršen, a relevantni dokazi se ne mogu pružiti ili će biti teže dobiti, sud može i pre pokretanja postupka o meritornim stvarima izricati privremenu meru radi očuvanja uslovnih dokaza o zaštiti poverljivih informacija.</p> <p>2. Privremenom merom navedenom u stavu 1. ovog člana, sud može naročito naložiti:</p>

<p>2.1. përshkrimin e detajuar të produkteve të dyshuara për shkeljen e dizajnit, me ose pa marrjen e mostrave;</p> <p>2.2. sekuestrimin e produkteve shkelëse</p> <p>2.3. sekuestrimin e materialeve dhe mjeteve të përdorura për prodhimin, shpërndarjen e produkteve shkelëse si dhe dokumentacionit që ka të bëjë me to.</p> <p>3. Masat e përkohshme të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni mund të urdhërohen, nëse është e nevojshme, pa u dëgjuar pala kundërshtuese, nëse aplikuesi vërteton dhe e bën të qartë se ekziston rreziku që dëshmia mund të shkatërrohet ose që çfarëdo vonese ka mundësi të shkaktojë dëm të pariparueshëm për mbajtësin e dizajnit. Njoftimi duhet t'u jepet palëve të prekura pa vonesë më së voni deri në ekzekutimin e masave. Një shqyrtim, përfshirë të drejtën për t'u dëgjuar, duhet të bëhet sipas kërkesës së palës së prekur me qëllim të vendimmarrjes, brenda një kohe të arsyeshme pas njoftimit të masës, nëse duhet të modifikohet, revokohet ose konfirmohet.</p> <p>4. Në vendimin që e urdhëron masën e përkohshme, gjykata duhet ta specifikojë kohëzgjatjen e masës së tillë dhe nëse masa është urdhëruar para fillimit të procedurave gjyqësore, periudhën brenda së cilës aplikuesi duhet të iniciojë veprime ligjore për ta arsyetuar masën, e që duhet të jetë brenda afatit</p>	<p>2.1. a detailed description of products suspected to infringe the design with or without sampling;</p> <p>2.2. seizure of infringing products;</p> <p>2.3. seizure of materials and tools used in production, distribution of infringing products, and documentation related to it.</p> <p>3. The interim measures set forth in paragraph 1 of this Article may be ordered, if necessary without hearing the opposing party, if the applicant confirms and makes it clear that there is a risk that the evidence may be destroyed or that any delay is likely to cause an irreparable harm for design holders. Notification must be given to the affected parties no later than the execution of measures. A review, including the right to be heard, should be made at the request of the affected party for the purpose of making a decision on, within a reasonable time after notifying the measure, whether it should be modified, revoked or confirmed.</p> <p>4. In a decision ordering an interim measure, the court must specify the duration of such measure and if the measure is ordered before the start of court proceedings, the period within which the applicant should initiate legal action to justify the measure, which should be within twenty (20) working days and not more than</p>	<p>2.1. detaljan opis proizvoda za koje se sumnja da su prekršili dizajn, sa ili bez uzorkovanja;</p> <p>2.2. oduzimanje proizvoda koji čine kršenja</p> <p>2.3. oduzimanje materijala i alata koji se koriste za proizvodnju, distribuciju proizvoda koji čine kršenja, kao i dokumentacija u vezi sa njima.</p> <p>3. Privremene mere iz stava 1. ovog člana mogu se naložiti, ako je potrebno, bez saslušanja protivne strane, ako aplikant potvrdi i jasno stavi do znanja da postoji rizik da dokazi budu uništeni ili da će verovatno kašnjenje naneti nepopravljivu štetu zadržavaocu dizajna. Obaveštenje se mora bez kašnjenja dostaviti pogođenim stranama najkasnije do izvršenja mera. Pregled, uključujući pravo na saslušanje, trebalo bi da se izvrši na zahtev pogođene strane radi donošenja odluke, u razumnom roku nakon obaveštavanja o meri, da li je treba izmeniti, opozvati ili potvrditi.</p> <p>4. U odluci kojom se nalaže privremena mera, sud mora navesti trajanje takve mere, a ako je mera naložena pre početka sudskog postupka, rok u kojem aplikant mora pokrenuti pravnu radnju radi opravdanja mere, koja mora biti u roku od dvadeset (20) radnih dana i ne više od trideset jednog (31) kalendarskog dana, koji</p>
---	---	--

<p>prej njëzet (20) ditë pune dhe jo më shumë se tridhjetë e një (31) ditë kalendarike, cilado që skadon më vonë nga dita e komunikimit të vendimit për paditësin dhe nëse padia nuk dorëzohet brenda kësaj periudhe, masa e përkohshme do të revokohet.</p> <p>5. Gjykata duhet të ketë autoritet të urdhërojë që masat për ruajtje të dëshmisë të kushtëzohen me deponimin e sigurisë adekuate nga i padituri apo një siguri ekuivalente të synuar për të siguruar kompensimin për çfarëdo paragjykimi siç parashihet në paragrafin 6 të këtij neni.</p> <p>6. Në rast se masat e përkohshme për ruajtje të dëshmisë revokohen apo skadojnë për shkak të çfarëdo veprimi ose lëshimi nga paditësi, ose ku është gjetur se nuk ka pasur shkelje apo kërcënim të shkeljes së ndonjë dizajni, gjykata mund ta urdhërojë paditësin, sipas kërkesës së kundërshtarit, që të paditurit t'i japë kompensim të duhur për çfarëdo dëmi të shkaktuar nga këto masa.</p> <p style="text-align: center;">Neni 68 Sigurimi i dëshmive gjatë procedurës civile</p> <p>1. Kur pala në procedurë civile kërkon dëshmi të cilat pretendon se i përkasin palës kundërshtuese apo që janë nën kontrollin e saj, gjykata e fton palën kundërshtuese që t'i paraqesë dëshmitë e tilla brenda afatit të caktuar kohor.</p>	<p>thirty (31) calendar days, whichever expires later than the day of decision communication to the claimant and if the claim is not submitted within this period, the interim measure shall be revoked.</p> <p>5. The court shall have the authority to order that measures for the preservation of evidence be conditional on the provision of adequate security by the respondent or an equivalent security intended to provide compensation for any prejudice, as provided in paragraph 6 of this Article.</p> <p>6. In case the interim measures for preservation of evidence are revoked or expire due to any action or omission by the claimant, or where it was found that there was no infringement or threat of infringement of a design, the court may order the claimant, at the request of the opponent, to provide the respondent adequate compensation for any damage caused by these measures.</p> <p style="text-align: center;">Article 68 Providing evidence during the civil procedure</p> <p>1. When a party to the proceedings requires evidence that belongs to the opposing party or that are under its control, the court shall invite the opposing party to submit such evidence within a specified time.</p>	<p>god da istekne kasnije od dana saopštavanja odluke tužiocu i ako tužba ne bude podneta u ovom roku, privremeni mera će biti ukinuta.</p> <p>5. Sud treba da ima ovlašćenje da naredi da mere za očuvanje dokaza budu uslovljene deponovanjem odgovarajućeg obezbeđenja od strane tuženog ili ekvivalentnim obezbeđenjem čiji je cilj pružanje obeštećenja za bilo koju štetu iz stava 6. ovog člana.</p> <p>6. U slučaju da se privremene mere za očuvanje dokaza ukinu ili isteknu usled bilo kakvih radnji ili propusta tužioca ili ako se utvrdi da nije došlo do kršenja ili pretnje kršenjem dizajna, sud može naložiti tužiocu, na zahtev protivnika, da tuženom daje odgovarajuću naknadu za bilo koju štetu prouzrokovanu ovim merama.</p> <p style="text-align: center;">Član 68 Obezbeđivanje dokaza tokom građanskog postupka</p> <p>1. Kada strana u parničnom postupku zatraži dokaze za koje tvrdi da pripadaju protivničkoj strani ili koji su pod njegovom kontrolom, sud poziva protivničku stranu da izvede takve dokaze u zatom roku.</p>
--	---	---

<p>2. Me kërkesë të palës që ka prezantuar dëshmi për ta mbështetur shkeljen e një dizajni në një shkallë komerciale me qëllim të përfitimit material apo ekonomik dhe ka specifikuar gjatë procedurës dëshmi si: dokumente bankare, financiare ose dokumente komerciale nën kontrollin e palës kundërshtare, gjykata e fton palën kundërshtuese që t'i paraqesë dëshmitë e tilla brenda afatit të caktuar kohor, me kusht të ruajtjes së informacionit konfidencial.</p> <p>3. Kur pala ftohet që t'i paraqesë dëshmitë dhe nuk pranon se këto dëshmi i përkasin dhe janë nën kontroll të palës, gjykata mund t'i marrë dëshmitë për ta vërtetuar një fakt të tillë.</p>	<p>2. At the request of the party who has provided evidence to verify the infringement of a design at commercial level for the purpose of material or economic profit and has specified during the proceedings, evidence such as: bank documents, financial or commercial documents under the control of the opposing party, the court shall invite the opposing party to submit such evidence within the prescribed time limit, provided that confidential information is preserved.</p> <p>3. If the party invited to present testimony, refuses that evidences belong to them or are under its control, the court may take the evidences to prove such a fact.</p>	<p>2. Kada je strana koja je izvela dokaze koji podržavaju kršenje dizajna u komercijalnim razmerama u cilju materijalne ili ekonomske koristi i tokom postupka navela dokaze kao što su: bankarski dokumenti, finansijski ili komercijalni dokumenti pod kontrolom protivničke strane, sud poziva protivničku stranu da dostavi takve dokaze u propisanom roku, pod uslovom očuvanja poverljivosti podataka.</p> <p>3. Kada je strana pozvana da izvede dokaze i ne prizna da ti dokazi pripadaju strani i da su pod njenom kontrolom, sud može izvesti dokaze da dokaže takvu činjenicu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 69 Procedurat e përshpejtua</p>	<p style="text-align: center;">Article 69 Accelerated Procedures</p>	<p style="text-align: center;">Član 69 Ubrzani postupci</p>
<p>1. Procedura në lidhje me shkeljen e dizajnit duhet të jetë e përshpejtuar.</p> <p>2. Me kërkesë të gjykatës ose të palës që e ka iniciuar procedurën në lidhje me shkeljen e së drejtës së dizajnit, API e pranon kërkesën për shpalljen e pavlefshmërisë së vendimit për dizajnin industrial të regjistruar të paraqitur para ose gjatë procedurës dhe vepron në procedurë të përshpejtuar. Gjukata, duke i marrë parasysh rrethanat, mund ta vendos pezullimin e procedurës deri në marrjen e vendimit përfundimtar me kërkesë të palës për</p>	<p>1. The procedure concerning the infringement of an industrial design shall be subject to acceleration.</p> <p>2. Upon the request of the court or any of the parties to the proceedings concerning the infringement of an industrial design, the AIP shall accept the request for the announcement of invalidity of the industrial design, submitted before or in the course of the procedure, and shall act on accelerated procedures. The court, taking into consideration the circumstances of the case, shall decide to terminate the proceedings up to the final decision upon the</p>	<p>1. Postupak u vezi sa kršenjem dizajna treba ubrzati.</p> <p>2. Na zahtev suda ili strane koja je pokrenula postupak u vezi sa povredom prava na dizajn, AIV će prihvatiti zahtev za proglašenje nevažećim odluke o industrijskom dizajnu podnetu pre ili tokom postupka i postupiće po ubrzanom postupku. Sud uzimajući u obzir okolnosti može odlučiti da obustavi postupak do donošenja konačne odluke na zahtev strane za proglašenje nevažećim industrijskog dizajna.</p>

<p>deklarimin e pavlefshmërisë së dizajnit industrial.</p>	<p>request of the party to announce the invalidity of the industrial design.</p>	
<p>3. Masat e parapara në nenet 58-69 të këtij ligji zbatohen për çfarëdo shkelje të një dizajni industrial, përveç nëse ligjet e tjera i parashohin mjetet më të favorshme për mbajtësin e dizajnit.</p>	<p>3. The measures provided in Articles 58-69 of this Law shall apply to any infringement of an industrial design, unless other laws provide more favourable means for the holder of the design.</p>	<p>3. Mere predviđene u članovima 58.-69. ovog Zakona primenjivaće se na svako kršenje industrijskog dizajna, osim ako drugi zakoni ne predviđaju povoljnija sredstva za nosioca dizajna.</p>
<p>4. Masat, procedurat dhe mjetet e parapara në nenet 58-69 të këtij ligji duhet të jenë të drejta, të barabarta, proporcionale, të përbalueshme dhe zhbërëse. Ato nuk duhet të parashohin afate të paarsyeshme kohore apo vonesa të paarsyeshme dhe të zbatohen në mënyrë të tillë për ta parandaluar krijimin e barrierave për tregti legjitime dhe të ofrojnë mbrojtje kundër shkeljes së tyre.</p>	<p>4. The measures, procedures and means provided for in Articles 58-69 shall be fair, equal, proportionate, affordable and dissuasive. They should not provide for unreasonable time limits or unreasonable delays and be applied in such a manner as to prevent the creation of barriers to legitimate trade and provide protection against their infringement.</p>	<p>4. Mere, postupci i pravni lekovi predviđeni članovima 58-69 biće pravični, pravični, proporcionalni, pristupačni i odvrćajući. Ne bi trebalo da predviđaju nerazumna vremenska ograničenja ili nerazumna kašnjenja i treba da se primenjuju na takav način da spreče stvaranje prepreka legitimnoj trgovini i da pruže zaštitu od njihovog kršenja.</p>
<p>5. Në procedurat e neneve 58-69 të këtij ligji zbatohen dispozitat e Ligjit përkatës për Procedurën Kontestimore për shpenzimet procedurale për miratimin e kostove ligjore dhe shpenzimeve të palës së suksesshme. Çfarëdo shpenzimi procedural duhet të bartet nga pala humbëse. Në veçanti shpenzimet dhe tarifatat ligjore duhet të përfshijnë çdo shpenzim të ndërlidhur, siç janë shpenzimet e dëshmitarëve, tarifatat e avokatëve, ekspertëve dhe këshilltarëve teknikë të palëve dhe shpenzimet për zbulimin e shkelësve.</p>	<p>5. The provisions of the resoective Law on Contested Procedure on procedural expenses for the approval of legal costs and expenses of the successful party shall apply to the procedures of Articles 58-69 of this Law. Any procedural costs must be borne by the losing party. In particular, legal expenses and fees should include any related costs, such as costs for witnesses, fees for lawyers, experts and technical advisers to the parties, and costs for identification of violators.</p>	<p>5. U postupcima iz članova 58-69 ovog Zakona primenjuju se odredbe relevantnom Zakona o parničnom postupku o proceduralnim troškovima za odobravanje pravnih troškova i izdataka uspešne strane. Sve proceduralne troškove mora snositi strana koja gubi. Pravni troškovi i naknade posebno bi trebalo da uključuju sve povezane troškove, kao što su troškovi svedoka, honorari za advokate, stručnjake i tehničke savetnike strana i troškovi za otkrivanje prekršilaca.</p>

<p>KAPITULLI XI PËRFAQËSIMI</p>	<p>CHAPTER XI REPRESENTATION</p>	<p>POGLAVLJE XI ZASTUPANJE</p>
<p>Neni 70 Përfaqësimi nga përfaqësuesit e autorizuar</p>	<p>Article 70 Representation by authorized representatives</p>	<p>Član 70 Zastupanje od strane ovlašćenih predstavnika</p>
<p>1. Personat fizikë ose juridikë që e kanë vendbanimin ose selinë e veprimtarisë në Republikën e Kosovës mund t'i realizojnë të drejtat e tyre sipas këtij ligji edhe përmes përfaqësuesve të autorizuar, të cilët janë të regjistruar në regjistrin e përfaqësuesve, që e mban API.</p> <p>2. Personat fizikë ose juridikë të huaj, që nuk kanë vendbanimin ose seli të veprimtarisë në Republikën e Kosovës, mund t'i realizojnë të drejtat sipas këtij ligji në procedurat në Agjenci vetëm përmes përfaqësuesve të autorizuar të cilët janë të regjistruar në regjistrin e përfaqësuesve që e mban API.</p>	<p>1. Natural or legal persons, who have residence or business headquarters in the Republic of Kosovo, may exercise their rights according to this Law through authorized representatives who are registered in the register of representatives, maintained by the AIP.</p> <p>2. Natural or legal persons who do not have permanent residence or business headquarters in the Republic of Kosovo may exercise their rights according to this Law through proceedings at the Agency only by authorized representatives, registered in the representatives register maintained by the AIP.</p>	<p>1. Fizička ili pravna lica koja imaju prebivalište ili sedište u Republici Kosovo mogu da ostvaruju svoja prava prema ovom Zakonu preko ovlašćenih zastupnika, koji su upisani u registar zastupnika koji vodi AIV.</p> <p>2. Strana fizička ili pravna lica koja nemaju prebivalište ili sedište delatnosti u Republici Kosovo, mogu svoja prava prema ovom Zakonu da ostvare u postupcima u Agenciji samo preko ovlašćenih zastupnika koji su upisani u registar zastupnika koji vodi AIV.</p>
<p>Neni 71 Përfaqësuesit e autorizuar</p>	<p>Article 71 Authorized representatives</p>	<p>Član 71 Ovlašćeni predstavnici</p>
<p>1. Përfaqësimi i personave fizikë apo juridikë para Agjencisë mund të bëhet nga përfaqësues të autorizuar të regjistruar me vendim të Agjencisë në Regjistrin e përfaqësuesve që e mban API.</p> <p>2. API e regjistron dhe e çregjistron personin në Regjistrin e përfaqësuesve të autorizuar,</p>	<p>1. Natural or legal persons at the Agency may be represented only by the authorized representative, registered in the register maintained by the AIP.</p> <p>2. The AIP shall register and unregister persons from the register of the Authorized</p>	<p>1. Zastupanje fizičkih ili pravnih lica pred Agencijom mogu izvršiti ovlašćeni predstavnici registrovani odlukom Agencije u Registru zastupnika koji vodi AIV.</p> <p>2. AIV registruje i odjavljuje lica u Registru ovlašćenih predstavnika, u zavisnosti od toga</p>

<p>varësisht nëse ai person i plotëson apo nuk i plotëson kushtet të cilat janë të përcaktuara me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.</p>	<p>Representatives, subject to the fact if such person meets or does not meet requirements defined by sub-legal act. issued by the Minister.</p>	<p>da li to lice ispunjava ili ne ispunjava uslove propisane podzakonskim aktom koji donosi Ministarstvo.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 72 Autorizimi i përfaqësuesve të autorizuar</p>	<p style="text-align: center;">Article 72 Authorization of Authorized Representatives</p>	<p style="text-align: center;">Član 72 Ovlašćenje ovlašćenih predstavnika</p>
<p>1. Përfaqësuesi i autorizuar për dizajn industrial mund ta përfaqësojë një person fizik apo juridik para Agjencisë në bazë të autorizimit të lëshuar nga personi fizik apo juridik.</p> <p>2. Autorizimi mund të jepet për një ose më shumë aplikime apo regjistrime të dizajneve industriale, si për ato ekzistuese ose për të ardhmen.</p> <p>3. Autorizimi që lidhet me të gjitha aplikimet dhe regjistrimet e dizajneve industriale të një personi fizik apo juridik njihet si autorizim i përgjithshëm.</p> <p>4. Autorizimi mund të jetë i kufizuar vetëm për disa veprime të përcaktuara që ndërmerren pranë Agjencisë.</p> <p>5. Në rast se hiqet dorë nga dizajni industrial, autorizimi duhet t'i përmbajë qartë kërkesat e cekura nga pronari i dizajnit.</p>	<p>1. An authorized representative of industrial design may be represented by natural or legal person at the Agency based on authorization issued by natural or legal person.</p> <p>2. Authorization may be issued for one or more, existing or future, applications or industrial design registrations.</p> <p>3. Authorization for all applications and industrial design registrations for a natural or legal person shall be considered as general authorization.</p> <p>4. Authorization may be limited only for some defined actions undertaken at the Agency.</p> <p>5. If cases of waiver from industrial design, the authorization shall contain clearly claims mentioned by the design owner.</p>	<p>1. Ovlašćeni predstavnik za industrijski dizajn može zastupati fizičko ili pravno lice pred Agencijom na osnovu ovlašćenja izdatog od fizičkog ili pravnog lica.</p> <p>2. Odobrenje se može dati za jednu ili više aplikacija ili registracija industrijskih dizajna, bilo postojećih ili budućih.</p> <p>3. Ovlašćenje koje se odnosi na sve aplikacije i registracije industrijskih dizajna lica ili pravnog lica poznato je kao opšte ovlašćenje.</p> <p>4. Ovlašćenje može biti ograničeno samo na neke određene radnje koje preduzima Agencija.</p> <p>5. U slučaju odustajanja od industrijskog dizajna, odobrenje mora jasno sadržati zahteve koje je naveo vlasnik dizajna.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 73 Tërheqja e autorizimit</p> <p>1. Pronari i dizajnit mund ta tërheqë autorizimin e dhënë për përfaqësuesin e dizajnit në çdo kohë.</p> <p>2. Pasi të informohet për ndryshimin e përfaqësuesit, API vazhdon të komunikojë me përfaqësuesin e ri për dizajn apo drejtpërdrejt me pronarin e dizajnit.</p> <p>3. Nëse pronari i dizajnit u ka dhënë dy apo më shumë autorizime përfaqësuesve të ndryshëm për të njëjtin dizajn, është i vlefshëm autorizimi i fundit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 73 Withdrawal of the authorization</p> <p>1. The design owner may withdraw the given authorization to design representative at any time.</p> <p>2. After informing the AIP about the change of representation, Agency shall continue to communicate with the new design representative or directly with the design owner.</p> <p>3. The design owner, who has issued two or more authorizations to various representatives for the same design, the last authorization shall be valid.</p>	<p style="text-align: center;">Član 73 Povlačenje ovlašćenja</p> <p>1. Vlasnik dizajna može u bilo kom trenutku povući ovlašćenje dato predstavniku dizajna.</p> <p>2. Nakon što bude obavještena o promeni predstavnika, Agencija će nastaviti da komunicira sa novim predstavnikom dizajna ili direktno sa vlasnikom dizajna.</p> <p>3. Vlasnik dizajna koji je dao dva ili više ovlašćenja različitim predstavnicima za isti dizajn, poslednje odobrenje je važeće.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 74 Dorëzimi i autorizimit</p> <p>1. Përfaqësuesi i dizajnit industrial që pohon se është i autorizuar për ta përfaqësuar pronarin para Agjencisë, por nuk ia dorëzon Agjencisë autorizimin për të argumentuar, ftohet që në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e pranimit të ftesës të paraqesë një autorizim të vlefshëm.</p> <p>2. Me kërkesën e përfaqësuesit për dizajn industrial, afati kohor mund të vazhdohet edhe për gjashtëdhjetë (60) ditë të tjera nga data e skadimit të afatit të cekur në paragrafin 1 të këtij neni.</p>	<p style="text-align: center;">Article 74 Submitting the authorization</p> <p>1. An industrial design representative who claims to be authorized to represent the owner at the Agency, but does not submit the authorization at the Agency to argument, shall be invited to submit a valid authorization within sixty (60) days from the date of the receipt of the invitation.</p> <p>2. Upon request of the industrial design representative, the time limit may be extended for a maximum of sixty (60) days from the date of expiration of that time limit referred in paragraph 1 of this Article.</p>	<p style="text-align: center;">Član 74 Podnošenje ovlašćenja</p> <p>1. Predstavnik industrijskog dizajna koji tvrdi da je ovlašćen da zastupa vlasnika ispred Agencije, ali Agenciji ne dostavi ovlašćenje za dokazivanje, poziva se da u roku od šezdeset (60) dana od dana prijema poziva dostavi važeće ovlašćenje.</p> <p>2. Na zahtev predstavnika za industrijski dizajn, rok se može produžiti za još šezdeset (60) dana od datuma isteka roka iz stava 1. ovog člana.</p>

<p>3. Nëse përfaqësuesi për dizajn industrial nuk ia dorëzon Agjencisë autorizimin e vlefshëm brenda afatit kohor dhe vazhdon të veprojë në emrin e vet, veprimet e ndërmarra nga përfaqësuesi konsiderohen sikur të mos ishin ndërmarrë fare.</p>	<p>3. If industrial design representative does not submit valid authorization at the Agency within time limit and acts in his/her name, the action undertaken by the representative shall be deemed as not undertaken at all.</p>	<p>3. Ako predstavnik za industrijski dizajn ne dostavi Agenciji važeće ovlašćenje u roku i nastavi da deluje u svoje ime, smatraće se da radnje koje je preduzeo predstavnik uopšte nisu preduzete.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 75 Marrëdhënia me të drejtat e tjera të pronësisë industriale</p>	<p style="text-align: center;">Article 75 Relationship to other rights of industrial property</p>	<p style="text-align: center;">Član 75 Odnos sa drugim pravima industrijskog vlasništva</p>
<p>Dispozitat e këtij ligji nuk ndikojnë në zbatimin e dispozitave ligjore të tjera lidhur me markat tregtare apo shenjat e tjera dalluese, patentave si dhe dispozitave që e rregullojnë përgjegjësinë civile dhe konkurrencën jolojale.</p>	<p>The provisions of this Law shall not affect the application of other legal provisions related to trademarks or other distinctive signs, patents and provisions that regulate civil liability and unfair competition.</p>	<p>Odredbe ovog Zakona ne utiču na sprovođenje drugih zakonskih odredbi koje se odnose na žigove ili druge karakteristične znakove, patente i odredbe kojima se uređuje građanska odgovornost i nelojalna konkurencija.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 76 Marrëdhënia me të drejtën e autorit</p>	<p style="text-align: center;">Article 76 Relationship with copyright</p>	<p style="text-align: center;">Član 76 Odnos sa autorskim pravima</p>
<p>Dizajni i mbrojtur nga e drejta e dizajnit industrial i regjistruar në pajtim me këtë Ligj (në ose në lidhje me Republikën e Kosovës), duhet të ketë të drejtë për mbrojtje në bazë të Ligjit përkatës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, që nga data kur është krijuar dizajni. Shkalla në të cilën dhe kushtet në të cilat jepet një mbrojtje e tillë, duke përfshirë nivelin e origjinalitetit të kërkuar, duhet të përcaktohet me Ligjin përkatës për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.</p>	<p>Design protected by industrial design right registered in accordance with this Law, (in or in connection with the Republic of Kosovo), should be eligible for protection under the respective Law on Copyright and Related Rights, from the date when the design is created. The extent to and the conditions under which such protection is given, including the level of originality required, shall be determined by the respective Law on Copyright and Related Rights.</p>	<p>Dizajni zaštićeni pravom na industrijski dizajn registrovani u skladu sa ovim Zakonom (ili u odnosu na Republiku Kosovo), moraju imati pravo na zaštitu prema relevantnim Zakonom o autorskom i srodnim pravima, od datuma kada je dizajn kreiran. Obim i uslovi pod kojima se takva zaštita dodeljuje, uključujući potreban nivo originalnosti, treba da budu utvrđeni relevantnim Zakonom o autorskim i srodnim pravima.</p>

KAPITULLI XII DISPOZITAT NDËSHKUESE	CHAPTER XII PUNITIVE PROVISIONS	POGLAVLJE XII KAZNENE ODREDBE
<p style="text-align: center;">Neni 77 Dispozitat ndëshkuese</p> <p>1. Me gjobë në shumë prej pesë mijë (5,000) deri tetë mijë (8,000) euro ndëshkohet personi juridik i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare, në çfarëdo forme përdor produkte apo shërbime që i shkelin të drejtat e përcaktuara sipas nenit 17 të këtij ligji.</p> <p>2. Me gjobë në shumë shumë prej pesëqind (500) deri një mijë e pesëqind (1,500) euro ndëshkohet personi përgjegjës i personit juridik për shkeljet sipas nenit 17 të këtij ligji</p> <p>3. Me gjobë në shumë prej dy mijë (2,000) deri në pesë mijë (5,000) euro ndëshkohet personi fizik i cili ushtron biznes individual, dhe i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij tregtare, në çfarëdo forme përdor produkte apo shërbime që i shkelin të drejtat e përcaktuara sipas nenit 17 të këtij ligji.</p>	<p style="text-align: center;">Article 77 Punitive provisions</p> <p>1. A fine from five thousand (5,000) to eight thousand (8,000) euros shall be applied to legal person, who during business activity in any form uses the products or services by infringing the rights defined in Article 17 of this Law.</p> <p>2. A fine of five hundred (500) to one thousand five hundred (1,500) euros shall be imposed to the responsible person of the legal person according to Article 17 of this Law.</p> <p>3. A fine of two thousand (2,000) to fivethousand (5,000) Euros shall be imposed to a natural person who carries out individual business, and who during the exercise of his commercial activity in any form uses the products or services by infringing the rights defined in Article 17 of this Law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 77 Kaznene odredbe</p> <p>1. Novčanom kaznom u iznosu od pet hiljada (5,000) do osam hiljada (8,000) evra kazniće se pravno lice koje u toku izvršenja svoje komercijalne delatnosti u bilo kom obliku koristi proizvode ili usluge kojima se krše utvrđena prava iz člana 17. ovog Zakona.</p> <p>2. Novčanom kaznom u iznosu od petsto (500) do hiljadu petsto (1,500) evra kazniće se odgovorno lice pravnog lica u skladu sa člana 17. ovog Zakona.</p> <p>3. Novčanom kaznom u iznosu od dve hiljade (2,000) do pet hiljada (5,000) evra kazniće se fizičko lice koje obavlja individualni biznis i koje u toku svoje poslovne aktivnosti koristi proizvode ili usluge kojima se krše prava utvrđena u članu 17. ovog Zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 78 Nxjerrja e akteve nënligjore</p> <p>Ministri nxjerr akte nënligjore sipas nenit 21 paragrafi 4, neni 22 paragrafi 9, neni 23 paragrafi 5, neni 28 paragrafi 4, neni 30 paragrafi 3, neni 36 paragrafi 2, neni 38 paragrafi 3, neni 40 paragrafi 8, neni 44</p>	<p style="text-align: center;">Article 78 Issuance of sub-legal acts</p> <p>The Minister issues sub-legal acts according to article 21. paragraph 4, article 22 paragraph 9 article 23 paragraph 5, article 28 paragraph 4, article 30 paragraph 3 article 36 paragraph 2, article 38 paragraph 3 article 40 paragraph 8</p>	<p style="text-align: center;">Član 78 Donošenje podzakonskih akata</p> <p>Ministarstvo donosi podzakonske akte u skladu sa članom 21. stav 4, članom 22 stav 9, članom 23 stav 5, članom 28 stav 4, članom 30 stav 3, članom 36 stav 2, članom 38 stav 3, članom 40 stav 8, članom 44 stav 2 član 45,</p>

<p>paragrafi 2, neni 45 paragrafi 3, neni 46 paragrafi 2, neni 49 paragrafi 4, neni 50 paragrafi 6, neni 54 paragrafi 4 dhe neni 71 paragrafi 2, në afat prej dymbëdhjetë (12) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij ligji.</p>	<p>article 44 paragraph 2 article 45, paragraph 3 article 46. paragraph 2 article 49 paragraph 4, article 50 paragraph 6 article 54 paragraph 4 and article 71. Paragraph 2 within twelve (12) months from the entry into force of this law.</p>	<p>stav 3, član 46. stav 2, član 49 stav 4, član 50 stav 6, član 54 stav 4 i član 71. stav 2 u roku od dvanaest (12) meseci od stupanja na snagu ovog zakona.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 79 Aktet nënligjore të aplikueshme deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore</p> <p>1. Me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në nxjerrjen e akteve të reja nënligjore për zbatimin e drejtë dhe të plotë të këtij ligji, aktet nënligjore si në vijim të aplikueshme aktualisht do të vazhdojnë të mbeten në fuqi:</p> <p>1.1. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2016 për Regjistrimin e Dizajnit Industrial.</p>	<p style="text-align: center;">Article 79 Sub-legal acts applicable to the issuance of new legislation</p> <p>1. Provided that they are not in contradiction with this Law and until the issuance of new legislation to fairly and fully implement this Law, sub-legal acts currently applicable shall remain in force, as follows:</p> <p>1.1. Administrative Instruction No. 12/2016 on Industrial Design Registration.</p>	<p style="text-align: center;">Član 79 Podzakonski akti koji se primenjuju do donošenja novih podzakonskih akata</p> <p>1. Pod uslovom da nisu u suprotnosti sa ovim Zakonom i do izdavanja svih podzakonskih akata za poštnu i potpunu primenu ovog Zakona, trenutno primenljivi podzakonski akti i dalje će ostati na snazi kako sledi:</p> <p>1.1. Administrativno uputstvo br. 12/2016 o registraciji industrijskog dizajna.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 80 Dispozitat shfuqizuese</p> <p>Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr. 05/L-058 për Dizajnin Industrial.</p>	<p style="text-align: center;">Article 80 Repealing provisions</p> <p>Upon entry into force of this Law, the Law No. 05/L-058 on Industrial Design shall be repealed.</p>	<p style="text-align: center;">Član 80 Odredbe ukidanja</p> <p>Stupanjem na snagu ovog Zakona ukida se Zakon Br. 05 / L-058 o industrijskom dizajnu.</p>

<p align="center">Neni 81 Hyrja në fuqi</p>	<p align="center">Article 81 Entry into force</p>	<p align="center">Član 81 Stupanje na snagu</p>
<p>Ky ligji hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.</p> <p align="center">Glauk Konjufca</p> <hr/> <p>Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës</p>	<p>This Law shall enter into force fifteen (15) days after publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo.</p> <p align="center">Glauk Konjufca</p> <hr/> <p>President of the Assembly of the Republic of Kosovo</p>	<p>Ovaj Zakon stupa na snagu petnaest (15) dana nakon objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo.</p> <p align="center">Glauk Konjufca</p> <hr/> <p>Predsednik Skupštine Republike Kosovo</p>